

Në bazë të nenit 158-s pika 1) dhe nenit 74 pikat 8) dhe 9) të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018, dhe 198/2018), dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr.101/2019 dhe 31/2020), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve nxori

## **RREGULLORE<sup>1</sup>**

### **për metodën për përlogaritje të koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal**

#### **I. Dispozita të**

#### **përgjithshme**

#### **Neni 1**

(1) Me këtë rregullore nga afër përcaktohet:

1. Metodologjia për përlogaritje të koeficientit të likuiditetit dhe likuiditeti minimal të cilin shoqëritë e sigurimeve dhe/apo risigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: shoqëri të sigurimeve) janë të detyruara ta aplikojnë në menaxhimin me likuiditetin nga neni 103 i Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Ligji);
2. Planifikimi i hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare, kontrolli i rregullt i likuiditetit dhe miratimi i masave për ndalim apo mënjanim të arsyeve për jo likuiditet në përputhje me dispozitat nga neni 103 paragrafi (2) dhe (3) të Ligjit dhe
3. Përmbajtja, mënyra dhe afatet e raportimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

#### **Neni 2**

(1) Organi drejtues i shoqërisë të sigurimeve është i detyruar të miratojë akt të brendshëm me të cilin në mënyrë të detajuar do ta përcaktojë mënyrën e menaxhimit me likuiditetin, me çka do të përcaktohet strategji dhe politikë e shoqërisë të sigurimeve për menaxhim me likuiditetin në rrethana të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

(2) Organi drejtues i shoqërisë të sigurimeve është i detyruar të vendosë strukturë organizative, sistem të kontrollit të brendshëm, si dhe sistem të menaxhimit me informatat, të cilat do të zbatohen për matje, përcjellje, kontroll dhe raportim për likuiditetin.

---

<sup>1</sup> Teksti i konsoliduar i Rregullores është përpiluar në bazë të tekstit të Rregullores për **metodën e llogaritjes së koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64/2011), Rregullores për ndryshim dhe plotësimin e Rregullores për **metodën e llogaritjes së koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 61/2016) dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për **metodën e llogaritjes së llogaritjes së koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 118/2022). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime ligjore janë të vlefshme vetëm tekstet e publikuara në Gazetar Zyrtare të sipërpërmendura.

(3) Organi drejtues i shoqërisë të sigurimeve është i detyruar të sjellë plan me masa për ndalim, gjegjësisht largim të arsyeve për jo likuiditet.

### Neni 3

(1) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar në bazë të rregullt t'i planifikojë hyrjet dhe daljet e pritura (të sigurta dhe të pasigurta) të mjeteve monetare. Për këtë qëllim, shoqëria është e detyruar të përgatitë plane mujore të hyrjeve dhe daljeve të pritura të mjeteve monetare.

(2) Shoqëria e sigurimeve i përgatit planet nga paragrafi (1) i këtij neni në bazë të të dhënave nga evidenca e saj e punës.

## II. Mënyra e përllogaritjes së koeficientit të likuiditetit

### Neni 4

(1) Koeficienti i likuiditetit është tregues i cili e paraqet raportin ndërmjet mjeteve likuiduese dhe të maturuara, gjegjësisht obligimet të cilat së shpejti do të maturohen.

(2) Mjete likuiduese janë mjetet në vijim me të cilat disponon shoqëria e sigurimeve:

- mjete të parave në bankë dhe në arkë;
- depozita me afat
- depozita të transferuara nëse maturohen në shtatë ditët në vijim, gjegjësisht mund të revokohen në shtatë ditët në vijim; dhe
- letra me vlerë të cilat maturohen në një afat prej shtatë ditësh.

(3) Obligime të maturuara të shoqërisë të sigurimeve janë obligimet nga aktivitetet që lidhen direkt me sigurimet, obligime në bazë të veprimtarive të bashkësigurimit dhe risigurimit (bashkësigurim/risigurim pasiv), obligime në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve nga veprimtaritë e bashkësigurimit dhe risigurimit, obligime për provizion në bazë të veprimtarive të përfaqësimit dhe ndërmjetësimit në sigurim dhe obligime të tjera nga aktivitetet që lidhen direkt me sigurimet, obligime në bazë të investimeve, obligime ndaj të punësuarve dhe obligime të tjera të cilat kanë maturuar në ditën për të cilën përllogaritet koeficienti i likuiditetit.

(4) Obligime të shoqërisë të sigurimeve të cilat së shpejti do të maturohen janë obligimet nga aktivitetet që lidhen direkt me sigurimet, obligime në bazë të veprimtarive të bashkësigurimit dhe risigurimit (bashkësigurim/risigurim pasiv), obligime në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve nga veprimtaritë e bashkësigurimit dhe risigurimit, obligime për provizion në bazë të veprimtarive të përfaqësimit dhe ndërmjetësimit në sigurim dhe obligime tjera nga aktivitetet që lidhen direkt me sigurimet, obligime në bazë të investimeve, obligime ndaj të punësuarve dhe obligime të tjera të cilat do të maturohen në një afat prej shtatë ditësh.

(5) Mjete likuiduese sipas dispozitave nga paragrafi (2) i këtij neni nuk llogariten letrat me vlerë me të cilat nuk tregtohet në tregje të rregulluara financiare dhe për të cilat është e vështirë të përcaktohet vlera e tregut.

(6) Mjete likuiduese sipas dispozitave nga paragrafi (2) i këtij neni nuk llogariten letrat me vlerë të cilat janë të klasifikuara si letra me vlerë të cilat ruhen deri në maturim, përveç nëse të njëjtat nuk kanë maturuar, gjegjësisht maturojnë në shtatë ditët e ardhshme. Për qëllimet e përlllogaritjes së koeficientit të likuiditetit shoqëria e sigurimeve duhet t'i vlerësojë dhe shprehë këto mjete sipas vlerës objektive.

(7) Për obligime sipas dispozitave nga paragrafi (3) dhe (4) i këtij neni llogariten edhe obligimet bilancore dhe jashtë bilancore të cilat nuk mund të anulohen, ndërsa janë të lidhura me shpenzime të caktuara për periudhën, gjegjësisht obligime nga kontratat me afat.

(8) Për obligime sipas dispozitave nga paragrafi (3) dhe (4) i këtij neni llogariten edhe të gjitha shpenzimet e tjera të pritura të cilat nuk janë të shprehura si obligime në bilancin e gjendjes, por për të cilat është e sigurtë se do të krijohen në afat prej 24 orësh nga dita për të cilët përlllogaritet koeficienti i likuiditetit.

(9) Vlerësimi i normave individuale të cilat hyjnë në përlllogaritjen e koeficientit të likuiditetit kryhet në mënyrë të përcaktuar me rregulloren për metodën e vlerësimit të zërave të bilancit të gjendjes dhe përgatitjes së bilanceve afariste të shoqërive të sigurimeve.

## Neni 5

(1) Shoqëria e sigurimeve është likuiduese nëse koeficienti i likuiditetit nga neni 4 i kësaj rregulloreje është më i lartë apo i barabartë me 1.

(2) Shoqëria e sigurimeve është jo likuiduese nëse koeficienti i likuiditetit nga neni 4 i kësaj rregulloreje është më i vogël se 1.

## Neni 6

(1) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar në bazë ditore të përlllogaritë:  
- shumën e mjeteve likuiduese të nenit 4 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje;  
- shumën e obligimeve të maturuara të nenit 4 paragrafët (3), (4), (7) dhe (8) të kësaj rregulloreje;  
- koeficientin e likuiditetit të nenit 4 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje.

(2) Shoqëria e sigurimeve i përlllogarit shumat e mjeteve likuiduese, obligimeve të maturuara dhe koeficientin e likuiditetit të paragrafit (1) të këtij neni në Formularin KL).  
- Përlllogaritja e koeficientit ditor të likuiditetit, i cili është dhënë në aneksin e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj (në tekstin e mëtejshëm: Formular KL).

(3) Shoqëria e sigurimeve duhet ta nxitë përlllogaritjen e koeficientit të likuiditetit me dokumentacion adekuat nga i cili mund të vërtetohet saktësia e përlllogaritjes.

### **III. Plan me masat dhe veprimet e shoqërisë të sigurimeve në rast të jo likuiditetit**

#### **Neni 7**

- (1) Nëse organi drejtues i shoqërisë të sigurimeve vërteton se shoqëria e sigurimeve është jo likuiduese në përputhje me nenin 5 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje, për këtë do ta informojë Agjencinë brenda përfundimit të të ditës së ardhshme të parë të punës.
- (2) Raportimi nga paragrafi i kaluar i këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për shumën e plotë dhe strukturën e mjeteve likuiduese dhe obligimet e maturuara jo të shlyera të shoqërisë të sigurimeve, si dhe arsyet për pamundësi të pagesës dhe aktivitetet e ndërmarra dhe të planifikuara për largimin e pamundësisë së përkohshme për pagesë, gjegjësisht për largimin e arsyeve për jo likuiditet. Në të njëjtën kohë, duhet në mënyrë të detajuar të theksohet se cilat burime të mjeteve shoqëria i ka shfrytëzuar apo ka për qëllim t'i shfrytëzojë për tejkalimin e jo likuiditetit si dhe plan për hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare për periudhën e ardhshme prej tridhjetë ditësh.
- (3) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar së bashku me raportimin të aplikojë edhe përlllogaritje të koeficientit ditor të likuiditetit në Formularin KL të ditës për të cilin shoqëria e sigurimeve ka treguar jo likuiditet.

#### **Neni 8**

- (1) Organi drejtues i shoqërisë të sigurimeve është i detyruar të përgatitë dhe adoptojë plan me masa dhe të veprojë sipas tij në rast të jo likuiditetit të shoqërisë të sigurimeve. Plani llogaritet si pjesë përbërëse e akteve të shoqërisë të sigurimeve të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e likuiditetit nga neni 2 i kësaj rregulloreje.

### **IV. Përmbajtja, mënyra dhe afatet e raportimit**

#### **Neni 9**

- (1) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar ta raportojë Agjencinë për koeficientet ditore të likuiditetit në bazë mujore, brenda datës 15-të të muajit aktual për muajin paraprak, në Formularin KL.
- (2) Shoqëria e sigurimeve e dorëzon Formularin KL të plotësuar në mënyrë të rregullt në formë elektronike në formë të shkruar.

## V. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

**(Neni 10 i Rregullores për metodën për përllogaritje të koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 64/11)**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 tetor i vitit 2011.

**(Neni 10 i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për metodën për përllogaritje të koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 61/16).**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të zbatohet nga 1 prilli i vitit 2016.

(2) Shoqëritë janë të detyruara ta zbatojnë këtë rregullore me përpilimin e raporteve për tremujorin e dytë të vitit 2016.

**(член 2 од Правилникот за методот за пресметка на коефициентот на ликвидност и минималната ликвидност објавен во „Службен весник на Република Северна Македонија" бр. 118/22)**

Oвој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавување со "Службен весник на Република Северна Македонија" а ќе започне да се применува со доставување на известување за пресметка на дневни коефициенти на ликвидност за месец јуни 2022 година.

**(Neni 10 i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për metodën për përllogaritje të koeficientit të likuiditetit dhe likuiditetit minimal të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 118/22).**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" ndërsa do të fillojë të aplikohet me parashtrimin e raporzteve për përllogaritjen ditore të koeficionteve ditore të likuiditetit në muajin qershor të vitit 2022.

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve  
Kërste Shajnoski**

## Tekst i konsoliduar

(grupi)		
(emri i shoqërisë)		
(viti aktual)		
KL: Përlogaritje e koeficientit të likuiditetit		
		Shuma në den:
		(*)
		1
<b>MJETE LIKUIDUESE (I1+I2+I3+I4+I5)</b>	<b>I</b>	<b>0</b>
Mjete të parave në bankë dhe në arkë në valutë të vendit	I1	
Mjete të parave në bankë dhe në arkë në valutë të huaj	I2	
Depozita me afat	I3	
Depozita të transferuara nëse maturohen në shtatë ditët në vijim, gjegjësisht mund të revokohen në shtatë ditët në vijim	I4	
Letra me vlerë të cilat maturohen në afat prej shtatë ditësh (I5.1+I5.2+I5.3.)	I5	0
<i>Të klasifikuara si LV të cilat ruhen deri në maturim</i>	<i>I5.1</i>	
<i>Të klasifikuara si LV të disponueshme për shitje</i>	<i>I5.2</i>	
<i>Të klasifikuara si LV të ruajtura për tregti (sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit)</i>	<i>I5.3</i>	
<b>OBLIGIME (II1+II2)</b>	<b>II</b>	<b>#REF!</b>
<b>OBLIGIME TË MATURUARA (II1.1+II1.2+II1.3+II1.4)</b>	<b>II1</b>	<b>#REF!</b>
Obligime të maturuara në bazë të aktiviteteve të lidhura direkt me sigurimet, bashkësigurimet dhe risigurimet (II1.1.2+II1.1.3)	II1.1	0
<i>Obligime të maturuara në bazë të aktiviteteve të lidhura direkt me sigurimet, bashkësigurimet dhe risigurimet</i>		
<i>Obligime të maturuara për provizion</i>	<i>II1.1.2</i>	
<i>Obligime të tjera të maturuara nga aktivitetet të lidhura direkt me sigurimet</i>	<i>II1.1.3</i>	
Obligime të maturuara në bazë të investimeve	II1.2	
Obligime të maturuara ndaj të punësuarve	II1.3	
Obligime të tjera të maturuara	II1.4	
<b>OBLIGIME TË CILAT DO TË MATUROHEN SË SHPEJTI (II2.1+II2.2+II2.3+II2.4)</b>	<b>II2</b>	<b>#REF!</b>
Obligime në bazë të punëve të lidhura direkt me sigurimet, bashkësigurimet dhe risigurimet të cilat do të maturohen së shpejti (II2.1.1+II2.1.2+II2.1.3)	II2.1	0
<i>Obligime në bazë të aktiviteteve të lidhura direkt me sigurimet, bashkësigurimet dhe risigurimet të cilat do të maturohen së shpejti</i>	<i>II2.1.1</i>	
<i>Obligime për provizion të cilat do të maturohen së shpejti</i>	<i>II2.1.2</i>	
<i>Obligime të tjera nga aktivitetet e lidhura direkt me sigurimet të cilat do të maturohen së shpejti</i>	<i>II2.1.3</i>	
Obligime në bazë të investimeve të cilat do të maturohen së shpejti	II2.2	
Obligime ndaj të punësuarve të cilat do të maturohen së shpejti	II2.3	
Obligime të tjera të cilat do të maturohen së shpejti	II2.4	
<b>Koeficient i likuiditetit</b>		<b>#REF!</b>

(\*)Regjistrohet dita dhe muaji për të cilin është bërë përlogaritja për shembull: 01.03. nëse koeficienti lidhet me ditën e parë të muajit mars

